



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:014412
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05477645

C – IV. – 15 - 0627

Paditësja:

N B nga Mitrovica.

Kundër

E paditura:

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Prishtinë.

Për: Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, jashtë seancës dëgjimore, me **dt.20.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I. HUDHET poshtë si e pa pranueshme, padia e paditëses, N B nga Mitrovica e ushtruar kundër Vendimit, PEJ 194 – 0307 të dt.23.03.2015 të Autoritetit të Likuidimit (AL) pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë për Ndërmarrjen Shoqërore, (NSh) "Enti për Mjekësinë Fizikale dhe Rehabilitim" me seli në Pejë (në likuidim) .

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

Rrethanat Procedurale dhe Faktike :

Paditësja me dt.25.04.2015 në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), përmes dërgimit me postë, ka paraqitur ankesë kundër Vendimit, PEJ 194 – 0307 të dt.23.03.2015 të Autoritetit të Likuidimit (AL) në kuadër të të paditurës, AKP-së me seli në Prishtinë e për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën dhe në shumën e pa përcaktuar nga Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), "Enti për Mjekësinë Fizikale dhe Rehabilitim" me seli në Pejë (në likuidim) dhe se me këtë Vendim, AL-ja, ia ka refuzuar si të pa vlefshme këtë kërkesë të saj e më gjerësisht si në arsyetimin e këtij Vendimi.

Pala paditëse parashtresën e ka titulluar si “*ankesë*”, mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Me dt.16.1.2023, kjo gjykatë, me Urdhrin e saj, C – IV. – 15 – 0627 të dt.14.11.2023, ka urdhëruar paditësen, që në afatin prej 7 (shtatë) ditëve pas ditës së pranimit të këtij urdhri, t’*a plotësoj* padinë (ankesën) e saj të dt.22.04.2015 të ushtruar kundër Vendimit të AL-së, PEJ194 – 0307 të dt.23.03.2015, dhe atë duke e precizuar shumën e kërkesës së saj si dhe periudhën kohore për të cilat i kërkon pagat e pa paguara nga NSh, ”Enti për Mjekësinë Fizikale dhe Rehabilitim” me seli në Pejë (në likuidim), si dhe kësaj padie (ankese), t’*ia bashkangjes*, kopjen e Njoftimit të AKP-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kopjen e librezës së punës lidhure me Ndërmarrjen Shoqërore, (NSh) ”Enti për Mjekësinë Fizikale dhe Rehabilitim” me seli në Pejë (në likuidim), si dhe provat tjera në mbështetje të padisë (ankesës) së saj e nëse paditësja, nuk vepron brenda afati të dhënë sipas pikës I të dispozitivit të këtij urdhri, gjykata në bazë të nenit 36 të Ligjit, Nr.06/L – 086 të dt.30 maj 2019 të Dhomës e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), padinë/ankesën e saj, do të Hedh poshtë si të papranueshme ose të njëjtën padi (ankesë), do të refuzoj si e të pabazuar.

Paditësi, Urdhrin e kësaj gjykate C – IV. – 15 – 0627 të dt.14.11.2023, e sipas fletëkthesës së kësaj gjykate, e ka pranuar me dt.29.11.2023 dhe se i njëjta pas kalimit të afatit të dhënë në këtë Urdhër por edhe deri më tani nuk ka vepruar sipas Urdhrit të kësaj gjykate, C – IV. – 15 – 0627 të dt.14.11.2023 për t’*a plotësuar* padinë (kërkesën) e saj .

Arsyetimi ligjor:

Padia e paditëses, hedhet poshtë si e papranueshme.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata marr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Në bazë të nenit 33 dhe nenin 35 të Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme, bëhet fjalë për rregullimin e parashtresave përkatësisht të kërkesave dhe nisjen e procedurave në Dhomën e Posaçme dhe se në nenin 35 par.2 të këtij ligji parashihet se çka duhet të përmbaj një kërkesë/padi, si në rastin konkret.

Në nenin 35 të Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme, parashihet se :” *Një kërkesë apo ankesë përmban: lëndën dhe të gjitha faktet materiale që kanë të bëjnë me kërkesën ose ankesën, bazën për juridiksionin parësor të Dhomës së Posaçme në lidhje me kërkesën apo ankesën, argumentet ligjore mbi të cilat mbështetet kërkesa apo ankesa dhe një listë provash që paditësi synon t’i paraqes ...*”.

Po ashtu në nenin 36 paragrafi 2, pika 2.5 dhe 2.6 i Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, parashihet se: ”*Një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse: ... Dhoma e Posaçme ka juridiksion në bazë*

të nenit 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; ... kërkesa/ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 dhe 35 të këtij ligji”. Në rastin konkret pala paditëse, pranë DhPGJSK-së, ka paraqitur vetëm ankesën e të cilës ia ka bashkangjitur Vendimin e AL-së, PEJ 194 – 0307 të dt.23.03.2015 dhe se për këtë arsye, kjo gjykatë me Urdhrin e saj, C – IV. – 15 – 0627 të dt.14.11.2023, ka urdhëruar paditësen, që në afatin prej 7 (shtatë) ditëve pas ditës së pranimi të këtij urdhri, t’ua plotësoj padinë (ankesën) e saj të dt.22.04.2015 të ushtruar kundër Vendimit të AL-së, PEJ194 – 0307 të dt.23.03.2015, dhe atë duke e precizuar shumën e kërkesës së saj si dhe periudhën kohore për të cilat i kërkon pagat e pa paguara nga NSh, ”Enti për Mjekësinë Fizikale dhe Rehabilitim” me seli në Pejë (në likuidim) , si dhe kësaj padie (ankese), t’ia bashkangjes, kopjen e Njoftimit të AKP-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kopjen e librezës së punës lidhure me Ndërmarrjen Shoqërore, (NSh) ”Enti për Mjekësinë Fizikale dhe Rehabilitim” me seli në Pejë (në likuidim), si dhe provat tjera në mbështetje të padisë (ankesës) së saj e nëse paditësja, nuk vepron brenda afati të dhënë sipas pikës I të dispozitivit të këtij urdhri, gjykata në bazë të nenit 36 të Ligjit, Nr.06/L – 086 të dt.30 maj 2019 të Dhomës e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), padinë/ankesën e saj, do të Hedh poshtë si të papranueshme ose të njëjtën padi (ankesë), do të refuzoj si e të pabazuar.

Mirëpo, paditësja, Urdhrin e kësaj gjykate, C – IV. – 15 – 0627 të dt.14.11.2023, e sipas fletëkthesës së kësaj gjykate, e ka pranuar me dt.29.11.2023 dhe se i njëjta pas kalimit të afatit të dhënë në këtë Urdhër por edhe deri më tani nuk ka vepruar sipas Urdhrit të kësaj gjykate, C – IV. – 15 – 0627 të dt.14.11.2023 për t’ua plotësuar padinë (kërkesën) e saj, andaj edhe kjo gjykatë, padinë e paditëses N B nga Mitrovica e ushtruar kundër Vendimit, PEJ 194 – 0307 të dt.23.03.2015 të Autoritetit të Likuidimit (AL) pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, e hodhi poshtë si të pa pranueshme .

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, 33, 35, 36 dhe nenit 74 par.2 të Ligjit nr.06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par. 5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), gjykata vendos që secila palë t’i bart shpenzimet e veta procedurale.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS **2023:014412, 20.03.2024**

Gjykatësi
Agron Hoxhaj

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimi të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).